

20060650891

L I G J
PËR NGARKIM ME HUA TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKA
NDËRKOMBËTARE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR PROJEKTIN E
IMPLEMENTIMIT TË REFORMAVE NË SISTEMIN JURIDIK DHE GJYQËSOR DHE
PËRKRAHJE INSTITUCIONALE

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me hua te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore në shumë prej 10.000.000 EURO sipas Marrëveshjes për hua, dedikuar për realizimin e Projektit të implementimit të reformave në sistemin juridik dhe gjyqësor dhe përkrahje institucionale.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua sipas Projektit për implementimin e reformave në sistemin juridik dhe gjyqësor dhe përkrahje institucionale, e cila do të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 të këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar nga ai.

Neni 3

Afati për pagimin e huas nga neni 1 i këtij ligji është 17 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej 5 vjetësh dhe me shkallë kamate nga LIBOR +0.75% në vit.

Huaja do të paguhet në 24 këste gjysmëvjetore nga të cilat duke filluar prej 15 shtatorit 2011 deri më 15 shtator 2022 do të paguhet 23 këste të barabarta gjysmëvjetore në shumë prej 415.000 EURO dhe më 15 mars 2023 do të paguhet kësti i fundit në shumë prej 455.000 EURO.

Në grejs periudhën prej 5 vjetësh, që paraqet edhe periudhën e realizimit të projektit, do të paguhet vetëm kamata e huas.

Neni 4

Me datën ose menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për hua nga neni 2, paragrafi 1 i këtij ligji, paguhet provizion i njëhershëm-shpenzim në shumë prej 1% nga shuma e huas. Shuma e provizionit të njëhershëm mund të jetë edhe më e vogël se 1% në bazë të vendimit të marrë paraprakisht të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim-Banka Botërore.

Në shumën e mjeteve të patërhequra nga huaja paguhet provizion në lartësi prej 0,75% në vit të përcaktuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore.

Provizioni nga paragrafi 2 i këtij neni paguhet në gjysmëvjetor dhe atë më 15 mars dhe më 15 shtator çdo vit.

Neni 5

Për realizimin e Marrëveshjes për hua sipas Projektit për implementimin e reformave në sistemin juridik dhe gjyqësor dhe përkrahje institucionale, është kompetente Ministria e Drejtësisë.

Shfrytëzues të mjeteve të Huas sipas Projektit për implementimin e reformave në sistemin juridik dhe gjyqësor dhe përkrahje institucionale nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç Ministrisë së Drejtësisë është edhe Këshilli gjyqësor buxhetor.

Neni 6

Republika e Maqedonisë huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë prej Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa do të zbatohet prej 1 qershorit 2006.